



REPUBLIKA E SHqipërisë

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 34 Prot

Tiranë, më 08.04. 2010

VENDIM Nr. 1 dt. 23.03.2010

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 23.03.2010, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

Sipas pikave të rendit të ditës:

I. Diskutimi i projekteve të financuara nga buxheti i shtetit:

1. **Miratohet:** Projekt restaurimi çatish në 3 lagjet e Q. Historike, Berat
2. **Miratohet:** Restaurime mirëmbajtje në Qendrën Historike, Berat. (Paketë mirëmbajtje)
3. **Miratohet:** Projekt restaurimi banesa e Oso Kukës, Shkodër.
4. **Miratohet:** Projekt restaurimi banesa e Pashko Vasës, Shkodër.
5. **Miratohet:** Restaurimi i godinës së Muzeut Arkeologjik, Korçë. *(Të hartohet një projekt restaurimi si fazë e dytë, në të cilin të trajtohen të gjitha problematikat e mbetura të objektit, me qëllim përfundimtar atraksionin turistik.)*

II. Diskutimi i projekteve të cilat presin financim nga buxheti i shtetit:

1. **Miratohet:** Punime restauruese dhe valorizimi i termave romake në Apoloni.

III. Diskutimi i projekteve të financuara nga donacione private:

1. **Miratohet nga ana teknike:** Projekt për punime konservuese dhe restauruese që do të kryhen në tavanin e pikturuar të Teqesë së Helvetive, Berat. *(Zbatimi i projektit do të bëhet i mundur, vetëm pas hartimit të marrëveshjes mes Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ambasadës Amerikane).*
2. **Miratohet nga ana teknike:** Projekt restaurimi Hamami i Durrësit. *(Zbatimi i projektit do të bëhet i mundur, vetëm pas plotësimit të dokumentacionit ligjor për vënien në shfrytëzim të objekteve, sipas procedurave përkatëse).*
3. **Miratohet:** Projekti i rikonstruksionit të çatisë në kishën e manastirin e Ardenicës. *Projekti miratohet me vërejtjet.*
 - *Tjegullat që do të vendosen të jenë me përmasat e tjegullave aktuale dhe pa stampë.*

- Çatia të trajtohet me djeguliat e vjetra origjinale, të cilat do të përftohen nga revizionimi. Tegullat e vjetra të përdoren si ulluqe dhe ato të rejai të prodhuara në mënyrë manuale të shërbejnë si kapak.
4. **Miratohet:** Projekt restaurimi Kisha e Shën Gjergjit në Leshnicën e Sipërme, Sarandë.

IV. Diskutimi i projekteve të infrastrukturës

1. **Miratohet:** Projekti i Hidrocentralit të Ashtës, Komuna Bushat, Qarku Shkodër.

V. Diskutimi i kërkesave të individëve:

1. **Do të diskutohet në mbledhjen e ardhshme:** Kërkesa për rikonstruksion banese me pronar Fatmir Lame, Elbasan.
2. **Do të diskutohet në mbledhjen e ardhshme:** Kërkesa rikonstruksion, ndërtim 2 katësh i pronarit Mihal Gërço. (Projekti i miratuar në parim nga KKR me Vendim nr. 19, dt. 06.11.2007).
3. **Miratohet:** Projekt rikonstruksioni dhe përshtatje e kompleksit të banesave të djegura, lagjia Goricë. Berat (Banesa nr.1 dhe Banesa nr.2)
4. **Nuk u miratua:** Projekt rikonstruksioni dhe shtesë kati të objektit të z. Gani Çela. Berat

VI. Diskutimi i kërkesave për licensë

1. **Miratohet:** Kërkesë për pajisje me licensë të kategorisë B, për nënkategorinë B/1, e Z. Sotir Kosta
2. **Miratohet:** Kërkesë për pajisje me licensë të kategorisë A, për nënkategoritë A/2, A/3, A/4, e Z. Arben Biçoku

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
FERDINAND XHAFERRAJ



SEKRETAR I KKR
PROF. DR. VALTER SHTYLLA

